

Mundësi për aplikim në thirrjen “A European Collaborative Cloud for Cultural Heritage – Innovative tools for high-value interactions with visitors and heritage objects HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01-04” nën Programin Horizon Europe

Synimi i Thirrjes:

Kjo thirrje synon zhvillimin e mjeteve dhe metodave inovative për të ofruar ndërveprime cilësore midis vizitorëve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore përmes “Reve Bashkëpunuese Europiane për Trashëgiminë Kulturore” (European Collaborative Cloud for Cultural Heritage) (ECCCH).

Objektivat kryesore përfshijnë:

- Krijimi, Shpërndarja dhe Ripërdorimi i Përmbajtjeve Interaktive.
Mbështetje për krijimin e përmbajtjeve multimediale që mund të përdoren në mënyrë të përsëritur dhe bashkëpunuese nga institucione të ndryshme.
- Analizimi, Dizajnimi dhe Testimi i Ndërveprimeve me Vizitorët.
Zhvillimi i mjeteve për të analizuar dhe përmirësuar ndërveprimet në hapësira reale ose virtuale ekspozimi.

Rezultatet e Pritshme:

- Përdorim i gjerë i ECCCH nga profesionistët dhe studiuesit për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve interaktive.
- Rritja e aftësiave për planifikimin, simulimin dhe dizajnimin e hapësirave reale dhe virtuale të ekspozimit.
- Analizimi i përdorimit efektiv të hapësirave të ekspozimit për të rritur ndërveprimet dhe kënaqësinë e vizitorëve.

Karakteristikat Kryesore:

- Zhvillimi i mjeteve të lehta për t’u përdorur për krijimin e përmbajtjeve interaktive nga përdorues të ndryshëm, përfshirë institucione arsimore dhe organizata jo-fitimprurëse.
- Mbështetje për ripërdorimin e komponentëve dhe përmbajtjeve të krijuara nga partnerë të tjerë të ECCCH, duke ulur kostot e prodhimit të përmbajtjeve të reja.
- Integrimi i mjeteve për simulime 3D dhe realitet virtual për të ndihmuar në dizajnimin dhe analizimin e hapësirave të ekspozimit.

Kriteret e Konsorciumit:

Të përfshihen të paktën **3 entitete** ligjore të pavarura nga vende të ndryshme të BE-së ose vende të asociuara, të paktën **1 nga Vendet Anëtare** dhe **2 nga Vendet Anëtare dhe Vendet e asociuara**.

Buxheti:

Buxheti total për këtë thirrje është **8 milionë euro** dhe thirrja do të financojë **2 projekte** me grante që variojnë nga **3 deri në 4 milionë euro për projekt**.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi kryhet përmes portalit të BE-së për Financime dhe Tendera dhe afati i fundit për dorëzimin e projekt-propozimeve është më datë **22 Janar 2025, ora 17:00 (ora e Brukselit)**

Link i Thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01-04?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43108390&callIdentifier=HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>